



Breaking News:

Drejtoria Vendore e Policisë Korçë, gjatë 24 orëve të fundit



10/04/2025

DVP Vlorë – Finalizohet Operacioni I Koduar “Nightfall 2”, Goditet Një Rast I Armëmbajtjes Pa Leje

DVP Vlorë/Kontrolle intensive në të gjithë territorin e qarkut, me qëllim evidentimin dhe goditjen e çdo veprimtari kriminale apo paligjshmërie që cenon sigurinë e qytetarëve.

Finalizohet operacioni policor i koduar “Nightfall 2”, goditet një rast i armëmbajtjes pa leje.

Sekuestrohen 1 armë zjarri pistoletë, me një krehër me fishekë, dhe fishekë për armë zjarri kallashnikov.

Vihet në pranga 34-vjeçari që i mbante të fshehura në banesë.

Arma e zjarrit do të dërgohet në Institutin e Policisë Shkencore për ekspertizë, me qëllim zbardhjen nëse është përdorur në ngjarje kriminale të ndodhura më parë

Strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë, në zbatim të planit të masave për garantimin e rendit dhe sigurisë publike, kanë vijuar kontrollet dhe ndërhyrjet intensive në të gjithë territorin e qarkut, me fokus goditjen e rasteve të armëmbajtjes pa leje dhe të çdo veprimtarie të paligjshme që rrezikon jetën dhe sigurinë e qytetarëve.

Në këtë kuadër, mbi bazën e informacioneve të siguruara në rrugë operative, shërbimet e Komisarariatit të Policisë Vlorë, mbrëmjen e djeshme, organizuan dhe finalizuan operacionin policor të koduar “Nightfall 2”.

Si rezultat i këtij operacioni, u arrestua në flagrancë për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, shtetasi B. A., 34 vjeç, banues në fshatin Tragjas.

Gjatë kontrollit të ushtruar në ambientet e banesës së këtij shtetasi, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan 1 armë zjarri pistoletë me krehër me fishekë, si dhe dhjetëra fishekë për armë zjarri kallashnikov.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



Download on the App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ Tiranë – Policia identifikon dhe shpall në kërkim një 32-vjeçar që plagosi me armë zjarri një shtetas, mbrëmjen e djeshme, gjatë një konflikti për motive të dobëta

Kavajë – U konfliktuan fizikisht dhe me sende të forta, procedohen penalisht 6 shtetas ▶